



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 311 prot.

Tiranë, më 16. 02. 2021

V E N D I M

Nr. 26, datë 16. 02. 2021

Mbështetur në ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën Nr. 76, datë 20.07.2020, të Fondacionit “Së Bashku”¹, kundër Bashkisë Durrës dhe Operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të aftësisë së kufizuar*.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Misioni i Fondacionit “Së Bashku”, është të promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në nivel kombëtar dhe lokal. Fokusohet veçanërisht në të drejtat për aksesueshmëri dhe jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuar, por gjithashtu merret edhe me arsimin gjithëpërfshirës, pjesëmarrjen në jetën publike etj.

Sipas palës ankuese, gjatë zbatimit të nismës “Të veprojmë së bashku për aksesueshmërinë” dhe nga dëshmitë e marra nga personat me aftësi të kufizuar, banorë të kësaj bashkie, është konstatuar që transporti publik në Bashkinë Durrës, është i pa aksesueshëm. Pamundësia për të marrë shërbimin e transportit publik, vjen si pasojë e mungesës së elementëve të aksesueshmërisë si më poshtë:

- Mungesa e rampave të cilat janë të nevojshme për ta bërë transportin publik të aksesueshëm;
- Mungesa e zbatimit të standardeve teknike për aksesueshmërinë e stacionëve të autobuzave të transportit publik;

¹ Përfaqësuar nga znj. S. L., në cilësinë e Drejtores Ekzekutive

- Mungesa e afshimit të orareve dhe të itenerareve në stacionet e autobuzëve përbën pengesë për personat që nuk flasim dhe dëgjojnë;
- Gjatë lëvizjes së autobuzit nuk njoftohet vendodhja e stacioneve me anë të një shpjegimi audio.

Përsa më sipër, pala ankuese pretendon se nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuar nuk pasqyrohen në politikat e ndjekura në nivel vendor dhe qendror. Domosdoshmëria për përmirësimin e aksesueshmërisë në transportin publik është urgjent. Kufizimi i të drejtës për aksesueshmëri në transport, kufizon automatikisht të drejtën për punësim, arsim, të drejtën për një jetesë të lirë dhe të pavarur.

Pra, sipas palës ankuese, personat me aftësi të kufizuar ndodhen përpara shkeljes së një sërë të drejtash të sanksionuara nga Kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, pretendohet që personat me aftësi të kufizuar janë trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe diskriminuese, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pala ankuese ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Të konstatojë situatën diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara;
2. Të marrë masë administrative me gjobë ndaj institucioneve publike dhe private përgjegjëse për moszbatimin e legjislacionit mbi aksesueshmërinë në transportin publik për personat me aftësi të kufizuar.
3. Rregullimi i problematikave që vijnë si më poshtë:
 - Konsultimi me grupin e interesit të personave me aftësi të kufizuar në të gjitha fazat e procesit të përmirësimit të aksesueshmërisë së transportit publik duke i konsideruar ata jo vetëm si grup interesi, por edhe si banorë të këtij qyteti;
 - Në fazën e përfundimit të një projekti të realizuar nga Bashkia Durrës, ky grup interesi duhet të bëjë kolaudimin e veprës apo projektit, sigurisht përsa i përket aksesueshmërisë;
 - Pajisjen e rrjetit të transportit publik me autobuz të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuar;
 - Trajnimin e personelit për të ofruar shërbim cilësor dhe human edhe për personat me aftësi të kufizuar;
 - Përshtatjen e stacionëve të autobuzëve dhe zbatimin e të gjitha parametrave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar;

- Afishimin e itinerarëve të lëvizjeve orare të autobusëve dhe gjithashtu, informacion vizual dhe audio të stacionëve përgjatë udhëtimit me autobus, duke i bërë ata të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim;
- Zbatimi i legjislacionit nga subjektet që ofrojnë shërbimin e transportit publik për përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për aksesueshmërinë në transportin publik.

Masat e mësipërme që kërkohet të merren nga Komisioneri, bazohen në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Neni 9 të ligjit nr. 108/2012 “Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 2, pika b dhe neni 11 i ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 4, pika i dhe neni 3, pika 37 i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- Neni 2, pika b, neni 45/1 i VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”². Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara nga ana e Bashkisë Durrës, pasi transporti publik në këtë qytet, është i pa aksesueshëm për këtë kategori.

² Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative. 2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.”

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra, që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Fillimisht ankuesi ka identifikuar si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa, Bashkinë Durrës. Gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se subjekti në fjalë, pra Bashkia Durrës, ka lidhur kontrata shërbimi me dy shoqëri transporti në linjat qytetase, me Shoqërinë “Tri

Trans sh.p.k.” dhe *“Maren Buss sh.p.k.”*. Pra, veç mungesës së aksesueshmërisë së stacionëve të autobuzëve, nga ana e subjektit ankues u evidentua edhe fakti i mungesës së aksesueshmërisë së autobuzëve për personat me aftësi të kufizuar.

Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i Ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun III, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20/1 të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1086 prot., datë 23.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Bashkia Durrës për ankesën e bërë nga Fondacioni *“Së Bashku”*. Në mënyrë të specifikuar është kërkuar:
 - Argumentimi i Bashkisë Durrës, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Informacion lidhur me numrin e shoqërive private të cilat ofrojnë shërbimin e transportit publik në Bashkinë Durrës.
- Informacion dhe kopje të Kontratës Tip që nënshkruhet mes Bashkisë Durrës dhe shoqërive private të cilat ofrojnë shërbimin e transportit publik në Durrës.
- Informacion nëse autobuzët e transportit publik në Durrës, plotësojnë kushtet për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.
- Informacion nëse ka vendqëndrim (strehë) në secilin nga stacionet për personat me aftësi të kufizuar. Nëse po, në cilat linja?
- Informacion nëse janë afishuar apo publikuar itineraret e lëvizjeve orare të autobuzëve në transportin publik të Bashkisë Durrës.
- Informacion nëse ofrohet shërbim vizual dhe audio përgjatë udhëtimit me autobus, për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim.
- Numri i stacione që janë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuar.
- A përdoret rampa për të hipur në mjetet e transportit publik përdorues të karrigeve me rrota? Nëse po, në cilat linja?
- A ka vende të rezervuara posaçërisht në autobus për personat me aftësi të kufizuar? Nëse po, në cilat linja? Sa vende?
- Informacion nëse janë kryer apo parashikuar investime nga ana e Bashkisë Durrës, për të bërë të mundur aksesimin e stacioneve të autobuzëve nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 417 586 705 AA, rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga punonjësja S. B., pra Bashkia Durrës ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësja e këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

2. Në mungesë të përgjigjes së Bashkisë Durrës, nëpërmjet shkresës me nr. 1036/1 prot., datë 28.09.2020, Komisioneri i është drejtuar sërish përmes një kujtesë për dërgimin e informacionit, duke i njoftuar përsëri që brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e shkresës të paraqesin parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 413 768 194 AA, datë 01.10.2020 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga punonjësi A. L., pra Bashkia Durrës ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësi i këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Në vijim, Bashkia Durrës, pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

3. Për shkak të mungesës së informacionit të vënë në dispozicion, Komisioneri në vijim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin Nr. 137, datë 14.10.2020, ka dënuar me gjobë në vlerën

200.000 (dyqind mijë) lekë Bashkinë Durrës për mosdhënien e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës Nr. 76, datë 20.07.2020.

Në përgjigje të vendimit të sipërcituar, Bashkia Durrës, me shkresën⁴ nr. 9647/1 prot., datë 14.10.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Shërbimi i linjave të transportit qytetas që funksionojnë në Bashkinë Durrës kryhet përmes dy kompanive përkatësisht Maren Bus dhe Iri Trans të përzgjedhura fillimisht përmes procedurës së konkursit dhe më tej përmes zbatimit të udhëzimit nr. 5267, datë 16.11.2016.*

- Shumica e autobusëve janë të pajisur me rampa hidraulike dhe mekanike dhe pjesa tjetër e autobusëve kanë rampa të lëvizshme që përdoren sa herë që kërkohen nga PAK, pasi është kusht dhe për rinovimin e kontratës.

- Të tëra linjat janë të pajisura me vendstrehim (strehë), por në secilën prej tyre ka 2-4 stacione pa vendstrehim (strehë) për arsye të pranisë së objekteve me strehë ose të stacioneve shumë të afërta.

- Në disa linja janë të afishuara inteneraret dhe oraret.

- Shërbimi vizual dhe audio nuk përdoret pasi i komunikon fatorino i autobusit.

- Stacionet që janë të pajisura me vendqëndrim mund të qëndrojnë të gjithë kategoritë e personave që përdorin shërbimin e transportit.

- Rampat përdoren sa herë është e nevojshme për tu përdorur dhe kërkohet nga personat PAK.

- Në të gjitha linjat ka vende të rezervuara posaçërisht për PAK, numri i tyre varion nga 2-4 sipas autobuseve.

- Bashkia Durrës e ka prioritet dhe vizion për ato të cilat nuk janë arritur të realizohen nga operatorët deri më tani në lidhje me shërbimet ndaj personave PAK, Bashkia Durrës do të marrë masat e nevojshme për ti komunikuar dhe kërkuar zbatimin e të gjithë legjislacionit për PAK.

- Të gjitha mangësitë e konstatuara në funksion të ofrimit të shërbimit të transportit për personat me aftësi të kufizuara, institucioni jonë do të marrë masat për zbatueshmërinë e këtyre nevojave gjatë fazës së hartimit të studimeve, projekteve, dokumentave të ndryshme për zgjidhjen e këtyre problematikave në vijim.”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Bashkia Durrës, vuri në dispozicion të KMD-së, vetëm kopje të kontratave të subjekteve të transportit me institucionin e Bashkisë Durrës.

4. Në kushtet që nga ana e Bashkisë Durrës u vu në dispozicion një pjesë e informacionit të kërkuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin nr. 158, datë 06.11.2020, shfuqizoi vendimin me gjobë nr. 137, datë 14.10.2020.

5. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresave nr. 1480 prot., datë 29.10.2020 dhe nr. 1480/1 prot., datë

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1086/1 prot., datë 16.10.2020

03.11.2020, Komisioneri njoftoi palën ankuese, Bashkinë Durrës dhe Shoqëritë e transportit qytetas “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë **10.11.2020**.

Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore Komisioneri ka kërkuar nga palët shpjegime dhe kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Informacion dhe dokumentacion provues nëse autobuzët e transportit publik në Durrës, plotësojnë kushtet për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar (foto të autobuzëve gjatë ofrimit të shërbimit personave me aftësi të kufizuara).
- Informacion dhe prova (foto) nëse ka vendqëndrim (strehë) në secilin nga stacionet për personat me aftësi të kufizuar. Nëse po, në cilat linja?
- Informacion nëse janë afishuar apo publikuar itineraret e lëvizjeve orare të autobuzëve në transportin publik të Bashkisë Durrës. (Nëse po, foto të stacioneve ku janë të afishuara oraret).
- Informacion nëse ofrohet shërbim vizual dhe audio përgjatë udhëtimit me autobus, për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim.
- Sa stacione janë të përshtatura për personat me aftësi të kufizuar?
- A përdoret rampa e mjeteve të transportit publik nga ana e personave me karrige me rrota? Nëse po, në cilat linja?
- A ka vende të rezervuara posaçërisht në autobus për personat me aftësi të kufizuar? Nëse po, në cilat linja? Sa vende?
- Informacion nëse janë kryer apo parashikuar investime nga ana e Bashkisë Durrës, për të bërë të mundur aksesimin e stacioneve të autobuzëve nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Në seancë dëgjimore u paraqit Znj. Sh. P., e autorizuar për të përfaqësuar pranë KMD-së Fondacionin “Së Bashku” dhe dy përfaqësues⁵ të Bashkisë Durrës, ndërsa nga ana e dy shoqërive të transportit qytetas të Bashkisë Durrës, nuk u paraqit asnjë përfaqësues. Përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku” parashitroi edhe një herë pretendimet e saj, duke u fokusuar tek mungesa e rampave tek mjetet e shërbimit urban, të cilat pengojnë aksesin e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë në qytetin e Durrësit, si dhe mungesa e aksesueshmërisë në stacionet e autobuzëve në Durrës.

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se institucioni që ata përfaqësojnë çdo vit i kërkon shoqërive të transportit qytetas, të rinovojnë flotën e mjeteve të transportit publik. Sipas tyre, pjesa më e madhe e mjeteve të transportit publik (autobuzëve), disponojnë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa një pjesë e vogël e tyre nuk e kanë rampën e inkorporuar, por e vendosin atë mekanikisht nëpërmjet një platforme të lëvizshme, sipas rastit kur nevojitet. Monitorimi fizik ndaj mjeteve të shërbimit urban kryhej nga ana e sektorit përgjegjës, për të cilat

⁵ Z. M. XH., me detyrë Inspektor Transporti dhe Znj. K. B., me detyrë Juriste në Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Durrës.

u sqarua se do t'i vënë në dispozicion të Komisionerit në vijim të procedurës së shqyrtimit të ankesës në fjalë. Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën që në monitorimet e kryera deri më sot, nuk ka rastisur të këtë patur udhëtarë me aftësi të kufizuar, kështu që nuk është evidentuar përdorimi i rampave levizëse.

Sa i përket, aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës, sqaruan se pavarësisht se mjetet e transportit publik (autobuzët qytetas) ofrojnë këtë shërbim, nuk përdoret, pasi nuk kërkohet nga ana e përdoruesve të transportit publik apo nga subjektet në fjalë. Megjithatë, sipas tyre ky shërbim audio ofrohet nga ana e fatorinove, të cilët verbalisht njoftojnë mbërritjen në secilin stacion.

Lidhur me afishimin e itinerareve të lëvizjeve, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës sqaruan se, pavarësisht kërkesës së tyre, drejtuar shoqërive të transportit, për publikimin e itinerareve të lëvizjeve, ky shërbim nuk ofrohet nga të gjitha mjetet e transportit në Durrës.

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se pretendimet e tyre me shkrim do të dorëzoheshin në vijim të seancës dëgjimore, duke iu përgjigjur edhe kërkesave të parashtruara nga përfaqësuesit e KMD-së, lidhur me:

- Numrin e autobusëve të cilët plotësojnë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe sa prej tyre jo;
- Numrin e stacionëve të autobusëve që kanë të afishuar oraret dhe itinerarin e lëvizjeve të mjeteve të transportit publik;
- Numrin e stacionëve të autobusëve të cilët plotësojnë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe sa jo.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua nëpërmjet e-mailit zyrtar, Bashkisë Durrës, duke kërkuar informacionin e parashtruar gjatë seancës dëgjimore sa i përket kërksave të palës ankuese.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar nga ana e Bashkisë Durrës, u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion shtesë lidhur me çështjet e ngritura gjatë seancës dëgjimore dhe gjatë shqyrtimit të ankesës së Fondacionit “Së Bashku”.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 76, datë 20.07.2020, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe jo të barabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pretendimi për diskriminim i Fondacionit “Së Bashku” mbështetet në faktin që transporti publik, referuar mjeteve të transportit dhe stacionëve të autobusëve, në Bashkinë Durrës, është i pa aksesueshëm. Pra në shërbimin e transportit publik, nuk garantohet aksesueshmëria fizike e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Mos ofrimi i lehtësive për këtë kategori individësh me aftësi të kufizuara fokusohet në disa aspekte:

- Mungesa e rampave të cilat janë të nevojshme për ta bërë transportin publik të aksesueshëm;
- Mungesa e zbatimit të standardeve teknike për aksesueshmërinë e stacionëve të autobusave të transportit publik;
- Mungesa e afishimit të orareve dhe të itinerareve në stacionet e autobusëve përbën pengesë për personat që nuk flasim dhe dëgjojnë;
- Gjatë lëvizjes së autobusit nuk njoftohet vendodhja e stacioneve me anë të një shpjegimi audio.

Rastet e parashtruara nga pala ankuese reflektojnë pikërisht mosofrimin e këtyre lehtësive në transportin urban qytetas në qytetin e Durrësit. Gjatë hetimit administrativ të kësaj ankese, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa u konsideruan edhe Shoqëritë e transportit “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, autobusët e të cilëve rezultuan se ofronin shërbimin urban qytetas në linjat qytetase, të cilat lidhen me ofrimin e lehtësive për sa i përket aksesueshmërisë fizike në autobus.

Kuadri ligjor i zbatueshëm:

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷. Bazuar në nenin 116, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: *“2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;...”*

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: *“Aksesueshmëri”* është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: *“3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi*

verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.” Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve (neni 5/1).

Për sa më sipër, legjislacioni shqiptar siguron mbrojtje të të drejtave të kategorisë së individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë pjesë e grupit të individëve me aftësi të kufizuara. Ligji nr.8626, datë 22.06.2000 “*Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik*” (i ndryshuar) parashikon detyrimin e shtetit për të krijuar kushte për të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) *pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar* (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedisore ku ofrohen shërbime publike.(Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “*Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara*”. Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

Në kreun I, neni 1, pikat 19, 20, 21 dhe 22, përcaktohet se : “19. *Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes. 20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të*

drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm. 21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni. 22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe transporti. Në gërmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: *“Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ë) në transport....”*. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, jetesa e pavarur, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe transporti.

Neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)⁸ gjithashtu parashikon: *“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta...”*

Njëkohësisht, në referencë të neneve 13-14 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)⁹, transporti qytetës është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e

⁸ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

⁹ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe

popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregullt me autobusë brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat për transport qytetës, është autoriteti përgjegjës që organizon, drejton, financon dhe kontraktin, sipas rastit, kryerjen e këtij transporti me autobusë brenda juridiksionit të vet.

Në pikën 9 të saj, VKM-ja nr. 1074, datë 23.12.2015, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” parashikon se shërbimet e transportit publik ofrojnë transport qytetas me mjete tërësisht të përshtatura, minimumi çdo 1 (një) orë në çdo vendqëndrim dhe shërbim transporti ndërqtetas me mjete të përshtatura për personat me vështirësi në lëvizje, minimumi një herë në ditë.

Njëkohësisht, në këtë kuadër vlejné të përmenden edhe parashikimet e Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Neni 26, i kësaj VKM-je parashikon shprehimisht: “1. Në mjetet e transportit si tramvaji, autobusi, metro, rezervohen të paktën tri vende për t’u ulur personat me aftësi të kufizuara lëvizëse në afërsi të portës së daljes. 2. Personave me aftësi të kufizuara lëvizëse ju lejohet hyrja dhe nga porta e daljes. 3. Në brendësi të mikrobusit të shkollës duhet të jetë rezervuar një hapësirë me gjerësi që të lejojë qëndrimin e karriges me rrota, pa penguar kalimin. Kjo hapësirë duhet të jetë e pajisur me ganxha, të vendosura në mënyrë të përshtatshme për të kryer bllokimin e karriges me rrota. 4. Mjetet e caktuara për transportin e përbashkët të personave në rrugë për përdorim publik duhet t’i përgjigjen karakteristikave të ndërtimit të përcaktuara me akte ligjore në fuqi. 5. Vagonat e trenit brenda tyre duhet të jenë të pajisur në mënyrë të përshtatshme për të lejuar sistemimin e një invalidi në karrige me rrota, dhe të vendosen në përbërje të trenave të linjave kryesore.”

Sikurse vihet re nga kuadri ligjor i sipërpërmendur, sigurimi i aksesueshmërisë për individët me aftësi të kufizuara, dhe në rastin konkret individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë konsiderohet prioritar. Në rastin e transportit urban qytetas përgjegjësia për të monitoruar plotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike të automjeteve të transportit urban është e njësisë të qeverisjes vendore. Në pikën 6, të nenit 23 “Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet: “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ...6. Transportin publik vendor”.

Neni 26, i ligjit të sipërpërmendur, parashikon: “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në

ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”

Për sa më sipër, referuar Kontratave të Shërbimit nr. 11952 prot., datë 28.09.2020 dhe nr. 11950 prot., datë 28.09.2020, të lidhura ndërmjet Bashkisë Durrës dhe “Iri Trans sh.p.k.” dhe Kontratave të Shërbimit nr. 11460 prot., datë 01.07.2019 dhe nr. 9451/1 prot., datë 06.08.2020, të lidhura ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë “Maren Buss sh.p.k.”, rezulton se këta operator ofrojnë shërbimin urban qytetas. Në bazë të kontratave të mësipërme rezulton se ato përmbajnë parashikime, lidhur me detyrimin e Bashkisë Durrës dhe të operatorëve të shërbimit për ofrimin e lehtësirave dhe sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuara.

Fillimisht në nenin 6¹⁰ dhe nenin 7¹¹ Në nenin 12 të Kontratave të sipërcituara parashikohet se Bashkia Durrës ka detyrimin të monitorojë, inspektojë dhe çertifikojë shërbimin e kryer nga operatorët. Gjithashtu në nenin 7 dhe 8 të kontratave të sipërcituara, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e Operatorit të Linjës, shprehimisht në pikën 2 dhe 3 citohet se: “2. bën informatizimin e stacioneve duke vendosur në të gjitha stacionet e autobusëve informacionet e duhura për udhëtarët, brenda formatit standard dhe afatit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, duke përfshirë rrjetin e linjave në tërësi, linjat që kalojnë në këtë stacion (harta e linjave me të cilën lidhet ky stacion dhe harta e rrjetit të linjave të qytetit) dhe oraret e shërbimit; 3. Pajis mjediset e brendshme të mjeteve me informacionin mbi itinerarin e linjës, brenda afatit dhe sipas formatit të miratuar nga dispozitat ligjore në fuqi”.

Ndërsa në nenin 10 të kontratave të shërbimit me operatorët, përcaktohet se: “5. Të zotërojë mjete me pajisje të veçanta për transportin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), në zbatim të ligjeve në fuqi.”

Pavarësisht sa më sipër, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se Bashkia Durrës nuk ka monitoruar zbatimin e kontratave të lidhura me operatorët “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, pasi ajo nuk ka depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së, asnjë raport monitorimi të autobusëve të linjave që mbulojnë shoqëritë e sipërcituara të transportit publik, si para edhe pas seancës dëgjimore¹² të zhvilluar pranë Komisionerit, mbi këtë çështje.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)¹³ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të

¹⁰ Parashikuar në kontratën me Shoqërinë Iri Trans sh.p.k.

¹¹ Parashikuar në kontratën me Shoqërinë Maren Buss sh.p.k.

¹² Referuar proçesverbalit të seancës dëgjimore rezulton se përfaqësuesit e Bashkisë Durrës janë shprehur se në vijim të saj do të vënë në dispozicion të Komisionerit, monitorimet e linjave të transportit.

¹³ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë

pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret Bashkisë Durrës dhe Shoqërive të transportit publik “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”. Në këtë rast, Bashkia Durrës dhe Shoqëritë e transportit publik “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.” duhet të provonin se nga ana e tyre janë marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin aksesueshmërisë fizike në transportit qytetës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të evidentonin qartësisht kontrollet dhe monitorimet e kryera ndaj operatorëve të shërbimit urban qytetas “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, apo edhe ndaj operatorëve të tjerë, si dhe masat respektive të marra ndaj subjekteve që kanë rezultuar se nuk kanë zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura dhe kontratave të shërbimit.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se individët me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit i janë nështruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Durrës.

Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se operatorët urban “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, duke u bërë palë në këtë procedim administrativ, refuzuan të bashkëpunojë me Komisionerin dhe njëkohësisht, në kushtet kur këto subjekte kanë patur barrën e provës për të vërtetuar, se kanë zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë Durrës, mbi sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuara dhe nuk kanë dhënë informacionin e kërkuar, prezumon faktin se pretendimet e Fondacionit “Së bashku” janë të vërteta.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, operatorët urban “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.” kanë ekspozuar ndaj personave me aftësi të kufizuara një qëndrim të padrejtë dhe disfavorizues, duke mos i siguruar dhe duke refuzuar të ofrojnë aksesueshmërinë fizike të tyre në mjetet e shërbimit urban, që këta operator përdorin për të ofruar shërbimin urban qytetas në qytetin e Durrësit.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 76, datë 20.07.2020, të Fondacionit “Së Bashku”, pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuara”, të personave me aftësi të kufizuara nga ana e Bashkisë Durrës dhe shoqëritë e transportit urban në qytetin e Durrësit.

“Aftësia e kufizuara” është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e palës ankuese për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Pala ankuese bën pjesë në kategorinë e grupit të personave me aftësi të kufizuara dhe si e tillë gëzon një sërë të drejtash në bazë të legjislacionit në fuqi.

Nën frymën e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁴, sikurse është përmendur edhe në paragrafët e mësipërm, ligjvënësi ka miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që mbrojnë shprehimisht të drejtën e individëve me aftësi të kufizuar për aksesueshmëri fizike e më gjerë, në fusha të ndryshme, sikurse edhe në atë të transportit.

Në referencë të nenit 3, të ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, “aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve. Sipas këtij ligji, ndër të tjera, me “pengesa” nënkuptohen edhe pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike.

Neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” siguron mbrojtje të individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

.....

f) lehtësi për transport ose udhëtim;

g) shërbimet e profesioneve të lira.

¹⁴Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuara ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit.....”

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Gjithashtu sipas neni 3/7 “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁵

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë Durrës gjatë seancës dëgjimore, rezultoi se një pjesë e mjeteve të transportit publik të operatorëve urban të shoqërive “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, të kontraktuar nga Bashkia Durrës, ishin të pajisur me platformën lëvizëse, që siguron aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në autobusë, ndërkohë për pjesën tjetër të këtyre automjeteve nuk u vu në dispozicion informacioni i plotë nëse janë të pajisur me një pajisje të tillë. Mungesa e një platforme lëvizëse në autobusët e këtyre shoqërive, përbëjnë një pengesë në kuptimin e ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, pasi pengon aksesin fizik në automjetet urbane qytetase, të individëve me aftësi të kufizuar, duke kufizuar mundësinë e tyre për të vetëprovuar.

Subjekti ankues pretendon se mungon aksesin për personat me aftësi të kufizuara, për të përdorur mjetet e transportit publik dhe nga ana e Shoqërive “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.” nuk është dhënë asnjë fakt dhe provë për të vërtetuar të kundërtën. Dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Shoqëritë e transportit “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standarteve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuar që marrin shërbime pranë “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, të cilët nuk përballen me barrierë/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tilla, Shoqëria “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.” bien ndesh me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, sikurse edhe me detyrimet kontraktore.

Referuar Komentit të Përgjithshëm nr. 6, *për barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar në vitin 2018, nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara, në pikën 18,

¹⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

parashikohet se: “...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”. I njëjti parashikim bëhet edhe në Komentin e Përgjithshëm nr.20, për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore në vitin 2009.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur që në rastin konkret është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshkruar personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mosrespektimit të standarteve të aksesueshmërisë të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Sipas KDKPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv. Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Edhe në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: “Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.”

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se : “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDKPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: “E drejta për aksesueshmëri për

personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambjentet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë”.

Për sa më sipër, shërbimi urban qytetas është një shërbim publik, i cili, sikurse është përmendur me sipër, menaxhohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në rastin konkret nga Bashkia Durrës. Detyrimi për të monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e parashikimeve të akteve të sipërpërmendura dhe përcaktimeve në kontratat e shërbimeve ka qenë detyrim i Bashkisë Durrës, e cila ka gjithashtu tagrin për të licencuar operatorët e shërbimit urban¹⁶ dhe për të marrë masa ndaj tyre në rast mospërbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre kontraktore. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Durrës nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se ky institucion nuk i ka kryer detyrimet e tij, duke diskriminuar individët objekt i ankesës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Nga faktet dhe provat e administruara nuk rezultoi që Bashkia Durrës të kishte marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standarteve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standarteve minimale që duhet të përmbushen, standarte këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashtuar edhe më sipër në këtë vendim.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioneri nuk është përgjegjës për vlerësimin e përmbushjes së standarteve të aksesueshmërisë në vetvete, por Komisioneri ka kompetencën që të vlerësojë nëse mungesa e standarteve të aksesueshmërisë ka sjellë ose jo si pasojë mohimin e aksesit në shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë, çështja që shtrohet në rastin konkret është nëse, mungesa standarteve teknike të aksesueshmërisë, ka sjellë si pasojë mohimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara nga Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.” në qytetin e Durrësit?

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: “Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara

¹⁶ Shih Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

të diskriminimit të bazuar në aftësi të kufizuara: (a) kur shërbimi ose objekti është krijuar pas miratimit të standarteve përkatëse të aksesueshmërisë.....”

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, plotësimi i standarteve të aksesueshmërisë me një pjesë të autobuzëve apo të stacioneve të tyre, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi që Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “*Maren Buss sh.p.k.*” dhe “*Iri Trans sh.p.k.*”, nuk kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuara.

Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme ka të bëjë me individin. Kjo do të thotë që detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrë *ex ante*. Për këtë arsye, subjektet, kanë për detyrë të sigurojnë aksesueshmërinë para se të marrin kërkesa për të hyrë në një vend ose për të përdorur/marrë një shërbim, nga ana e individit. Detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, kjo do të thotë që subjekti i detyruar për sigurimin e aksesueshmërisë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t’a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të kundërt, detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën ndonjë barrë të tepruar për subjektin. ¹⁷

Sikundër parashikohet edhe nga neni 9/2/c, i KDKPAK, trajnimi i personelit të shërbimit në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barriera dhe arritjen e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bashkia Durrës dhe Shoqëritë e transportit “*Maren Buss sh.p.k.*” dhe “*Iri Trans sh.p.k.*” nuk vunë në dispozicion prova të cilat provojnë se stafi i shërbimit pranë tyre ka marrë trajnime në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi i standarteve të aksesueshmërisë në autobuzët dhe stacionet e qytetit të Durrësit, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara në transportin publik në këtë qytet. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim të drejtëpërdrejtë sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” dhe se Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “*Maren Buss sh.p.k.*” dhe “*Iri Trans sh.p.k.*”, janë në shkelje të nenit 5, 7 dhe 20/1/b të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”.

¹⁷ Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “*Aksesueshmëria*”, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara , paragrafi 25

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, nuk kishin marrë masat për të siguruar standartet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Bashkisë Durrës dhe Shoqërive “Maren Buss sh.p.k.” dhe “Iri Trans sh.p.k.”, i standarteve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Gjithashtu, pavarësisht faktit që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është shprehur me vendimin Nr. 119, datë 09. 09. 2019, ku ka konstatuar diskriminimin e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Durrës dhe operatori i shërbimit urban qytetas “Maren Buss sh.p.k.”, evidentohet se vijon të mbetet e njëjta situatë edhe pse palët janë vënë në dijeni të vendimmarrjes së Komisionerit dhe detyrimeve që lindin nga zbatimi i tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas “Maren Buss sh.p.k.”.

3. Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas “*Iri Trans sh.p.k.*”.
4. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Durrës, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, në mjetet e transportit të shërbimit urban qytetas dhe përshtatjen e stacionëve të autobuzëve për personat me aftësi të kufizuar.
5. Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit “*Maren Buss sh.p.k.*”, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Në referencë të pikës 3, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit urban “*Iri Trans sh.p.k.*”, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
7. Në referencë të pikave 1, 2 dhe 3, Bashkia Durrës dhe Shoqëritë e transportit “*Maren Buss sh.p.k.*” dhe “*Iri Trans sh.p.k.*”, të marrin masa për trajnimin e stafit të shërbimit, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.
8. Marrja e masave si më sipër, duhet të realizohet nga ana e Bashkisë Durrës dhe Shoqërive të transportit “*Iri Trans sh.p.k.*” dhe “*Maren Buss sh.p.k.*”, brenda një afati prej 3 (tre) muajsh, nga dita e komunikimit të këtij vendimi.
9. Komisioneri i rekomandon Bashkinë Durrës që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së transportit publik, si në mjetet e transportit por edhe në stacionet tyre, të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
10. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “*Iri Trans sh.p.k.*” dhe “*Maren Buss sh.p.k.*”, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
11. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.

12. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)